**Republika e Kosovës – Republika Kosova**
***Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa***
***Izborni Panel za Žalbe i Predstavke***

**Anr. 374/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP),** në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 19.10.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. PRANOHET** pjesërisht e bazuar ankesa Anr. 374/2019 datë 16.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 3 fletëvotime në Vendvotimin BM015/001 dhe 1 fletëvotim në Vendvotimin BM019/001, të vlerësohen te vlefshme, dhe të njëjtat ti bashkëngjiten rezultatit përfundimtar, me rastin e shpalljes së të njëjtit.

**II. Refuzohet** pjesërisht e pabazuar ankesa Anr. 374/2019 e datës 16.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të shpallën të vlefshme të gjitha fletëvotimet në Vendvotimet : BM001/001, BM025/003, BM002/001, BM002/004, BM002/005, BM006/003, BM031/001, BM007/002, BM007/001, BM008/001, BM030/002, BM030/001, BM019/002, BM019/004, BM019/006, BM020/004, BM020/001, BM012/001, BM021/001, BM024/002, BM024/001, BM026/003, BM026/002, BM026/001, BM027/003 dhe BM010/003.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 16.10.2019, ka pranuar një ankesë Anr.374/2019 nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në të cilën pretendohet se më 16.10.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave me postë janë shpallur tri fletëvotime të

pavlefshme në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të Rregullës zgjedhore 06/2013, duke përcaktuar kritere shtesë të cilat nuk janë të parapara me dispozitat e rregullës në fjalë. Sipas parashtruesit të ankesës KQZ-ja i ka shpallur të pavlefshme këto tri fletëvotime me arsyetimin se fletëvotimet në fjalë janë printuar në formatin A4 PDF ndërsa KQZ i ka publikuar në formatin A3 PDF. Më tej shtojnë se gjatë printimit të këtyre fletëvotimeve rreshti i fundit nuk është printuar dhe se kjo ka qenë arsyeja pse KQZ i ka shpallur si të pa vlefshme këto fletëvotime. Në plotësimin e ankesës 374/3 te datës 17.10.2019 subjekti politik LVV thekson se KQZ-ja ka shpallur edhe 170 fletëvotime te tjera për arsye identike, vetëm se rreshti i fundit te fletëvotimeve nuk është shfaqur tërësisht , pra ka qene kriter jo ligjor mbi te cilën janë shpallur edhe këto fletëvotime si te pavlefshme. Parashtruesi i ankesës thekson se 170 fletëvotimet te cilat janë shpallur si te pavlefshme janë gjetur në kutitë e votimit për komunat si ne vijim:, BM001/001, BM025/003, BM002/001, BM002/004, BM002/005, BM006/003, BM031/001, BM007/002, BM007/001, BM008/001, BM030/002, BM030/001, BM015/001, BM019/002, BM019/001, BM019/004, BM019/006, BM020/004, BM020/001, BM012/001, BM021/001, BM024/002, BM024/001, BM026/003, BM026/002, BM026/001, BM027/003 dhe BM010/003.

Parashtruesi i ankesës thekson se i gjithë ky proces teknik është bere ne përputhje me nenin 4 te Rregullës Zgjedhore 03/2013 Votimi Jashtë Kosovës, pasi qe edhe neni 6 i rregullës Zgjedhore 06/2013 është respektuar ne përpikëri, ndërsa fletëvotimet te cilat janë shpallur te pavlefshme nuk kualifikohen ne asnjë kategori te përcaktuar me nenin 7 paragrafi 2 te rregullës Zgjedhore 06/2013 mbi te cilat këto fletëvotime mund te shpallen te pavlefshme.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 18.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ( KQZ) pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese thekson si në vijim: Qendra e Numërimit dhe Rezultateve gjatë numërimit të votave përmes postës ka hasur në fletëvotime të cilat për shkak të printimit në disa raste nuk vërehen të gjitha subjektet politike në fletëvotim. KQZ ka miratuar fletëvotimin e plotë në të cilin janë vendosur subjektet politike të certifikuara, të cilat janë radhitur sipas shortit të hedhur dhe të cilat kanë garuar për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të datës 06 tetor 2019. Në rastin e pretendimeve te palës ankuese, kemi fletëvotime të printuara pa një ose më shumë subjekte politike, dhe arsyeja se pse QNR i ka shpallur të pavlefshme këto fletëvotime, qëndron në faktin se fletëvotimet e printuar kanë përmbajtur të gjitha subjektet politike të certifikuara, dhe të radhitura sipas shortit në fletëvotim të cilin e ka miratuar KQZ. Si dëshmi ka bashkangjitur disa shembuj të fletëvotimeve të shpallura si të pavlefshme nga QNR-ja për arse se nuk përmbajnë te gjithë subjektet politike.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit te provave te bashkangjitura, ne ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është pjesërisht e bazuar**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutitë e votimeve: BM015/001, BM019/001, BM001/001, BM025/003, BM002/001, BM002/004, BM002/005, BM006/003, BM031/001, BM007/002, BM007/001, BM008/001, BM030/002, BM030/001, BM015/001, BM019/002, BM019/001, BM019/004, BM019/006, BM020/004, BM020/001, BM012/001, BM021/001, BM024/002, BM024/001, BM026/003, BM026/002, BM026/001, BM027/003 dhe BM010/003 janë shpallur nga ana e QNR-së 173 fletëvotime të pavlefshme, për shkak se në pjesën dërmuese të tyre nuk identifikohen të gjitha subjektet politike garuese, apo në disa prej tyre nuk ka votim fare për subjektin por vetëm për kandidatët, ndërsa në një pjesë të tyre përveç shenjës mbi subjektin identifikues në katrorin e dedikuar për të vendosur shenjën ka edhe ndonjë shenjë tjetër tek subjekti tjetër apo shenja e vendosur tek njëri subjekt ka kaluar apo i ka përshkruar dy subjekte. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit i ka shpallur të pavlefshme këto fletëvotime.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim te nenit 105 paragrafi 1 te LZP-së, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që këto fletëvotime të shpallen të vlefshme sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja nuk janë kritere që e bëjnë të pa vlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, përgjigjes në ankesë, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se për një pjesë të fletëvotimeve qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë fletëvotimet e gjetura në kutinë e votimit të cekur në pikën e -I-, të dispozitivit të këtij vendimi janë shpallur të pavlefshme, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtave ka rezultuar se nuk e përmbushin asnjërin kriter të pa vlefshmërisë, të njëjtat duhet të llogariten të vlefshme dhe rezultatet e të njëjtave duhet t'i bashkëngjiten rezultatit përfundimtar me rastin e shpalljes së të njëjtit. Ndërsa për pjesën dërmuese të fletëvotimeve te vendosura sikurse në pikën e II-të dispozitivit të këtij vendimi, me rastin e ekzaminimeve ka rezultuar i pa qëndrueshëm pretendimi ankimor, sepse ato fletëvotime nuk mund të llogariten të vlefshme për shkak se nuk janë të plota, në to nuk figurojnë të gjitha subjektet politike, ku në mungesë të evidentimit të ndonjërit subjekt në fletëvotim, ai fletëvotim nuk mund të llogaritet i vlefshëm sepse i njëjti nuk është i plotë. Kjo rregull zbatohet edhe me rastin e votimeve ditën e zgjedhjeve ku gabimet apo mungesat në ndonjë fletëvotim në ditën e zgjedhjeve, fletëvotimin e bëjnë jo të rregullt/plotë dhe rrjedhimisht të pa vlefshëm.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze"*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga vlefshmëria e fletëvotimeve si në pikën e I-rë, të dispozitivit të këtij vendimi, e të bashkangjitura me këtë vendim, duhet të përfshihet me rastin e shpalljes në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nga KQZ-ja.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**
**A nr. 374/2019 më datën 19.10.2019**

**Kryesuese e Panelit**
Gyltene Sylejmani

***Këshilla Juridike:*** *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*

BM 015/001

Z… VENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019
…ŠTINU REPUBLIKE KOSOVO 2019
…EYİ MECLİSİ ERKEN SEÇİMLERİ

1 Shënjoni VETËM NJË subjekt politik
Označite SAMO JEDAN politički subjekat
SADECE BİR siyasi kuruluşu işaretleyin

2 Shënjoni MË SË SHUMTI PESË kandidatë
Označite NAJVIŠE PET kandidata
EN FAZLA BEŞ aday işaretleyin

- [ ] 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE
- [ ] 112. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- [ ] 113. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
- [ ] 114. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA
- [ ] 115. PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS
- [ ] 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLINJVE TË KOSOVËS - PDAK
- [ ] 117. POKRET ZA GORA - PG
- [ ] 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- [ ] 119. AAK - PSD KOALICIONI 100% KOSOVË
- [ ] 120. SLOBODA
- [ ] 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- [ ] 122. NISMA SOCIALDEMOKRATE ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISË
- [ ] 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- [ ] 124. KOALICIJA VAKAT
- [ ] 125. FJALA
- [X] 126. LËVIZJA VETËVENDOSJE!
- [ ] 127. KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ - KDTP
- [ ] 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- [ ] 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- [ ] 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- [ ] 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- [ ] 132. ESMIR KASI
- [ ] 133. GRAĐANSKA INICIJATIVA GORE - GIG
- [ ] 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- [ ] 135. … LISTA

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | X |
| 9 | 10 | 11 | X |
| 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | 31 | 32 |
| 33 | 34 | X | 36 |
| 37 | 38 | 39 | 40 |
| 41 | 42 | 43 | 44 |
| 45 | 46 | 47 | 48 |
| 49 | 50 | 51 | 52 |
| 53 | 54 | 55 | 56 |
| 57 | 58 | 59 | 60 |
| 61 | 62 | 63 | 64 |
| 65 | 66 | 67 | 68 |
| 69 | 70 | 71 | 72 |
| 73 | 74 | 75 | 76 |
| 77 | 78 | 79 | 80 |
| 81 | 82 | 83 | 84 |
| 85 | 86 | 87 | 88 |
| 89 | 90 | 91 | 92 |
| 93 | 94 | 95 | 96 |
| X | 98 | 99 | 100 |
| 101 | 102 | 103 | 104 |
| 105 | 106 | 107 | 108 |
| X | 110 | | |

BM 015/001

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

**KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019**
**KUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVO 2019**
**RİYETİ MECLİSİ ERKEN SEÇİMLERİ**

**1** Shënjoni **VETËM NJË** subjekt politik
Označite **SAMO JEDAN** politički subje
**SADECE BİR** siyasi kuruluşu işaretley

- [ ] 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTI
- [ ] 112. PDK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- [ ] 113. PAI PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
- [ ] 114. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA
- [ ] 115. PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS
- [ ] 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
- [ ] 117. POKRET ZA GORA - PG
- [ ] 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- [ ] 119. AAK- PSD PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- [ ] 120. SLOBODA
- [ ] 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- [ ] 122. NISMA SOCIALDEMOKRATE AKR ALEANCA KOSOVA E RE PD PARTIA E DREJTËSISË
- [ ] 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- [ ] 124. KOALICIJA VAKAT
- [ ] 125. FJALA
- [x] 126. V LËVIZJA VETËVENDOSJE!
- [ ] 127. KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ - KDTP
- [ ] 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- [ ] 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- [ ] 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- [ ] 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- [ ] 132. ESMIR KASI
- [ ] 133. GRAĐANSKA İNİCİJATİVA GORE - GİG
- [ ] 134. LDK LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- [ ] 135. SRPSKA LISTA

**2** Shënjoni **MË SË SHUMTI PESË** kandidat
Označite **NAJVIŠE PET** kandidata
**EN FAZLA BEŞ** aday işaretleyin

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 ✓ | 2 ✓ | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 ✓ | 11 | 12 ✓ |
| 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | 31 | 32 |
| 33 | 34 | 35 | 36 |
| 37 | 38 | 39 | 40 |
| 41 | 42 | 43 | 44 |
| 45 | 46 | 47 | 48 |
| 49 | 50 | 51 | 52 |
| 53 | 54 | 55 | 56 |
| 57 | 58 | 59 | 60 |
| 61 | 62 | 63 | 64 |
| 65 | 66 | 67 | 68 |
| 69 | 70 | 71 | 72 |
| 73 | 74 | 75 | 76 |
| 77 | 78 | 79 | 80 |
| 81 | 82 | 83 | 84 |
| 85 | 86 | 87 | 88 |
| 89 | 90 | 91 | 92 |
| 93 | 94 | 95 | 96 |
| 97 | 98 | 99 | 100 |
| 101 | 102 | 103 | 104 |
| 105 | 106 | 107 | 108 |
| 109 ✓ | 110 | | |

BM 015/001

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

# KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019
# SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVO 2019
# KOSOVA CUMHURİYETİ MECLİSİ ERKEN SEÇİMLERİ

**1** Shënjoni VETËM NJË subjekt politik
Označite SAMO JEDAN politički subje[kt]
SADECE BİR siyasi kuruluşu işaretley[in]

- [ ] 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTI[ANE]
- [ ] 112. PDK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- [ ] 113. PAI PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
- [ ] 114. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA
- [ ] 115. PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS
- [ ] 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
- [ ] 117. POKRET ZA GORA - PG
- [ ] 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- [ ] 119. AAK- PSD PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- [ ] 120. SLOBODA
- [ ] 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- [ ] 122. NISMA SOCIALDEMOKRATE ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISË
- [ ] 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- [ ] 124. KOALICIJA VAKAT
- [ ] 125. FJALA
- [x] 126. V LËVIZJA VETËVENDOSJE!
- [ ] 127. KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ - KDTP
- [ ] 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- [ ] 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- [ ] 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- [ ] 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- [ ] 132. ESMIR KASI
- [ ] 133. GRAĐANSKA İNİCİJATİVA GORE - GİG
- [ ] 134. LDK LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- [ ] 135. SRPSKA LISTA

**2** Shënjoni MË SË SHUMTI PESË kandidat[ë]
Označite NAJVIŠE PET kandidata
EN FAZLA BEŞ aday işaretleyin

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | 31 | 32 |
| 33 | 34 | 35 | 36 |
| 37 | 38 | 39 | 40 |
| 41 | 42 | 43 | 44 |
| 45 | 46 | 47 | 48 |
| 49 | 50 | 51 | 52 |
| 53 | 54 | 55 | 56 |
| 57 | 58 | 59 | 60 |
| 61 | 62 | 63 | 64 |
| 65 | 66 | 67 | 68 |
| 69 | 70 | 71 | 72 |
| 73 | 74 | 75 | 76 |
| 77 | 78 | 79 | 80 |
| 81 | 82 | 83 | 84 |
| 85 | 86 | 87 | 88 |
| 89 | 90 | 91 | 92 |
| 93 | 94 | 95 | 96 |
| 97 | 98 | 99 | 100 |
| 101 | 102 | 103 | 104 |
| 105 | 106 | 107 | 108 |
| 109 | 110 | | |

BM019/001

...VENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019
...IPŠTINU REPUBLIKE KOSOVO 2019
...YETİ MECLİSİ ERKEN SEÇİMLERİ

**1** Shënjoni VETËM NJË subjekt politik
Označite SAMO JEDAN politički subjekat
SADECE BIR siyasi kuruluşu işaretleyin

- [ ] 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE
- [ ] 112. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- [ ] 113. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
- [ ] 114. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA
- [ ] 115. PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS
- [ ] 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
- [ ] 117. POKRET ZA GORA - PG
- [ ] 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- [ ] 119. AAK - PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- [ ] 120. SLOBODA
- [ ] 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- [ ] 122. NISMA SOCIALDEMOKRATE, ALEANCA KOSOVA E RE, PARTIA E DREJTËSISË
- [ ] 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- [ ] 124. KOALICIJA VAKAT
- [ ] 125. FJALA
- [x] 126. LËVIZJA VETËVENDOSJE!
- [ ] 127. KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ - KDTP
- [ ] 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- [ ] 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- [ ] 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- [ ] 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- [ ] 132. ESMIR KASI
- [ ] 133. GRAĐANSKA INICIJATIVA GORE - GIG
- [ ] 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- [ ] 135. SRPSKA LISTA

**2** Shënjoni MË SË SHUMTI PESË kandidat
Označite NAJVIŠE PET kandidata
EN FAZLA BEŞ aday işaretleyin

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 ✓ | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 ✓ |
| 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 ✓ | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 ✓ | 31 | 32 |
| 33 | 34 | 35 | 36 |
| 37 | 38 | 39 | 40 |
| 41 | 42 | 43 | 44 |
| 45 | 46 | 47 | 48 |
| 49 | 50 | 51 | 52 |
| 53 | 54 | 55 | 56 |
| 57 | 58 | 59 | 60 |
| 61 | 62 | 63 | 64 |
| 65 | 66 | 67 | 68 |
| 69 | 70 | 71 | 72 |
| 73 | 74 | 75 | 76 |
| 77 | 78 ✓ | 79 | 80 |
| 81 | 82 | 83 | 84 |
| 85 | 86 | 87 | 88 |
| 89 | 90 | 91 | 92 |
| 93 | 94 | 95 | 96 |
| 97 | 98 | 99 | 100 |
| 101 | 102 | 103 | 104 |
| 105 | 106 | 107 | 108 |
| 109 | 110 | | |